

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, përmës gjyqtares Mevlide Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani- Rahimi duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses N. A. nga Gj, rr., ,, kunder të paditures K. e Gj , të cilën sipas autorizimit e përfaqëson juristi S. F. nga Gj, me objekt kontesti, mospagesa e pagave pas pensionimit, në seancën gjyqësore dhe publike të datës 01.11.2017, bie këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadija e paditëses N. A. Nga Gj. me të cilën ka kërkuar që të **DETYROHET** e paditura K. e Gj , që paditëses t,ja paguaj shumën prej 1,296.00€, në emër të mos pageses së të ardhurave personale me kamatë ligjore për aq sa paguajnë bankat në Kosovë pa destinim të veçantë nga dita e ngritjes së padisë e deri ne pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. Obligohet e paditura që paditëses t,ja paguaj shpenzimet e procedurës edhe atë në emër të taksës për padi shumën prej 25€, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1. Rrijedha e çështjes

Paditësja N. A. nga Gj, në këtë gjykate ka ushtruar padi më date 12.08.2014, kundër të paditurës K. e Gj ,për kompenzimin e pagave, duke theksuar se me të padituren kishte lidhur kontratë pune me kohë të caktuar për zëvendësim – plotësim të normës sipas..., e dt. 25.02.2013, ndersa marrëdhënien e punes e kishte filluar me dt. 27.02.2013 e deri më 30.06.2013, me normë të plot prej 20 orëve ne javë si mësimdhënëse në lëndën e B.pranë Shkollës Fillore ,,, ne Gjilan, ku pas skadimit të kësaj kontrate me saktësisht me dt. 30.06.2013, kjo kontratë ishte shkëputur nga ana e punëdhënsit, mirëpo paditësja nuk i kishte realizuar të ardhurat personale për pagën bazë prej 216.00€ e që tani në shumë të përgjithshme prej 1,296.00€, për 4 muaj të mos pagesës edhe përkudner faktit se paditësja vazhdmisht kishte kërkuar që ti bëhet pagesa e të ardhurave sikurse çdo mësimdhënsi tjetër, andaj nga gjykata ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses t,ja paguaj shumën prej 1,296.00€, në emër të mos pagese së të ardhurave personale me kamatë ligjore prej 3.5% nga dita e ngritjes së padisë e deri ne pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Pas pranimit të padisë, kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur i ka dërguar padinë, në mënyrë që e njëjta të paraqesë përgjigje ne padi, e paditura ka ushtruar përgjegje ne padi, duke e kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.

2.Pretendimet e palëve ndërgjygjëse

Paditësja në seancën kryesore, si dhe në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke kërkuar që kërkesëpadia e saj të aprovohet në tërësi si e bazuar për faktin se sipas kontratës së punës për kohë të caktuar ka qenë mësimdhënëse në lëndën e B pranë ku pas skadimit të kësaj kontrate me saktësisht me dt. 30.06.2013, kjo kontratë ishte shkëputur nga ana e punëdhënësit, mirëpo paditësja nuk i kishte realizuar të ardhurat personale për pagën bazë prej 216.00€ e që tani në shumë të përgjithshme prej 1,296.00€, për 4 muaj të mos pagesës së të ardhurave personale, më tutje ka shtuar se ishte drejtuar DKA –së e cila ja kishte lëshuar vërtetimin e dt.03.07.2014, nga i cili shihet se e paditura e kishte pohuar se e njejtja kishte qenë në marrëdhënie të punës që nga dt. 27.02.2013 deri me dt.30.06.2013,dhe se nuk është paguar për shumën e të hollave prej 1,296€.

I autorizuari të paditurës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se nuk është kontestuese se paditësja me kontratën e punës për kohë të caktuar ka punuar si mësimdhënëse në Shkollën Filllore ,, ..., ne Gj edhe atë në bazë të vërtetimit të lëshuar nga DKA ne Gj , e nënshkruar nga Drejtori i Arsimit dhe për këtë periudhë sa ka punuar nuk është ekzekutuar pagesa e të ardhurave personale, pasi që ky fakt vërtetohet edhe nga formulari i listës së pagave të lëshuar nga personi i autorizuar..., ku është cekur me shkrim të dorës se paditësja nuk është paguar për këtë periudhë kohore, gjykatës i ka propozuar që pas shtjellimit të provave të nxjerr vendim meritor në bazë të ligjit.

3.Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata ka lexuar - dhe administruar këto prova:

Kontrata e punës për kohë të caktuar 05.nr.93/2013 e dt. 25.02.2013 e lëshuar nga DKA – Komuna e Gj. vërtetimi i dt. 03.07.2014, i lëshuar nga DKA –N. M, formulari i të dhënave për listën e pagave e dt. 01.06.2014, e nënshkruar nga B. S.

4.Vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatës

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjygjëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, nga të cilat ka gjetur se nuk është kontestuese në mes të palëve se paditësja ka qenë e punësuar tek e paditura në cilësinë e mësimdhënëses dhe si nuk është kontestues fakti për punën e kryer nuk e ka kompenzuar paditësen për shumën e të hollave prej 1296.00€, fakte të cilat u provuan edhe gjatë shqyrtimit kryesor të kësaj çështje ashtu që gjykata vendosi që kërkesëpadia është e bazuar dhe e njëjta duhet të aprovohet edhe atë konform nenit 55 të Ligjit të Punës ku në mënyrë shprehimore ceken Paga, kompensimi i pagës dhe të ardhurat e tjera, i punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit si dhe neni 2i këtij neni thotë se të drejtën për

pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.

Nga Kontrata e punës për kohë të caktuar ..e dt. ..e lëshuar nga DKA – Komuna e Gj, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja, ka qenë mësimdhënëse e lëndës së B, pranë Shkollës Fillore ,,, duke filluar nga data 27.02.2013 e deri me dt. 30.06.2013 dhe kjo kontratë ishte shkëputur automatikisht me dt.30.06.2013 nga ana e punëdhënësit.

Nga vërtetimi i dt. 03.07.2014, i lëshuar nga DKA – gjykata ka vërtetuar faktin se paditëses nuk ju ka ekzekutuar pagesa për periudhën kohore sa ka qenë në zëvendësim prej dt.27.02.2013 e deri me dt.30.06.2013 , për shumën e të hollave prej 1.296.00€.

Nga formulari i të dhënave për listën e pagave e dt. 01.06.2014, e nënshkruar nga B.S, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja nuk ishte paguar për këtë periudhë kohore prej dt.27.02.2013 e deri me dt.30.06.2013 , për shumën e të hollave prej 1.296.00€.

Andaj gjykata bazuar në gjendjen faktike të shpjeguar si më lartë ka ardhur në përfundim, se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, pasi që nga provat e administruara u vërtetua se paditësja ka të drejtën e kompenzimit të pagave edhe atë duke u mbështetur në Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar përkatësisht në nenin 36 paragrafi 9 dhe 10, si dhe nenin 51 të kësaj kontrate.

Në bazë të këtyre dispozitave ligjore në fuqi, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga arsyet e cekura më lartë, e bazuar edhe në nenin 143 të LPK, si dhe nenin 450 u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi. .

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.557/14, më datë 01.11.2017

Gjyqtarja,
Mevlide Shabani

Këshilla juridike : *Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate .*

